



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 02 qershor 2022, në vijim të mbledhjes së zhvilluar në datën 01 qershor 2022, u mbledh Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), përmes mjeteve të komunikimit në distancë (platformës zoom), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Refuzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “TIBO” sh.p.k. dhe lënien në fuqi të Vendimit për dënim me gjobë, nr. 15, datë 28.12.2021, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj shoqërisë “TIBO” sh.p.k. për subjektin “TIBO”, në masën 2 000 000 lekë. (**Vendimi nr. 62, datë 02.06.2022**)
2. Refuzimin e ankimit administrativ të shoqërisë “TIBO” sh.p.k. dhe lënien në fuqi të Vendimit për dënim me gjobë, nr. 2, datë 28.01.2022, të vendosur nga Grupi i Inspektimit ndaj shoqërisë “TIBO” sh.p.k. për subjektin “TIBO”, në masën 2 000 000 lekë. (**Vendimi nr. 63, datë 02.06.2022**)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 02 qershor 2022